

VIA: AIR
(SPECIFY AIR OR SEA POUCH)

DISPATCH NO. SGAA-8481
KAPOK #2395

K A P O K
SECRET
CLASSIFICATION

FEB 16 1954

TO : Chief, SE
Attn: []

DATE: _____
INFO: Chief, KUGOWN, []
Attn: []

SUBJECT: GENERAL— OBOPUS

SPECIFIC— OBTUSE Monthly Report, 15 January Through 14 February 1954

REF: SGAA-8097, 28 January 1954; SGAA-7955, 19 January 1954

1. The following is a post flight report of the OBOPUS 19/20 January leaflet raids:

- a. Date of drops: 19/20 January 1954
- b. Purpose: Leaflet and article raid
- c. General drop areas:
 - (1) Northern flight: Kruje, Burrel, Mati Dam, Blinisht, Puke, Kukes, Okul, Bushat, and on the highways between these villages.
 - (2) South Central flight: Terbac, Kanina, Selinice, Kukaj, Droshovits, Korce, Selinica and Kurvelesh.
- d. Leaflet title: Food Warning (Headquarters has leaflet - attachment to SGAA-7659, KAPOK-2248, 29 December 1953).
- e. Number of leaflets: 100,000
- f. OBEEKS - 150,000 November issue; 300,000 December issue (attached).
- g. 105 food parcels were dropped. Each parcel contained 5 cans of dehydrated foods.
- h. Aircraft encountered anti-aircraft fire in the vicinity of Shkoder and east of Elbasan. The Mati Dam was brightly lighted; Vlone was blacked out.

2. VALUABLE did not conduct a leaflet raid during this period.

DECLASSIFIED AND RELEASED BY
CENTRAL INTELLIGENCE AGENCY
SOURCE METHOD EXEMPTION 3B2B
NAZI WAR CRIMES DISCLOSURE ACT
DATE 2007

Attachment under separate cover
November and December ~~copy~~ (1 cy only to
15 February 1954 Wash)

RMW
RMW/WFH/lgk

Distribution: 3-Wash, w/att

SECRET KAPOK
CLASSIFICATION

FORM NO. 51-28A
MAR. 1949

1-Vital Documents, w/o att.; 2-[] w/o att; 1-Chrono, 1-Subject, 1-XO, 2-OBOPUS, w/o att.

SECRET

SEPARATE COVER ATTACHMENT TO SCAA-8481
KAPK-2395

WASHINGTON

FEB 16 1952

SECRET

SHQIPERIA

SHKURTIM LAJMESH

SHQIPERIA është organi zyrtar i Komitetit Kombëtar «SHQIPERIA E LIRE», një organizatë e përbërë nga përfaqësuesit e Shqiptarëve të çdo shtrësi shqiptare dhe lëvizje politike, të cilët marrin pjesë në kryqëzimet botërore kundër lirisë komuniste për çlirimin e Atdheut.



Komiteti Kombëtar «SHQIPERIA E LIRE», u është kushtuar këtyre punëve: 1) Të mbrojtë të drejtën e Shqiptarëve që të zgjedhin lirisht regjimin që u pelqen; 2) Të zhvillojë marrëdhënie të mira me Shtetet fqinje; 3) Të sigurojë njohjen e kufijve të shtetit shqiptarë dhe 4) Të japë Shqipërisë vendin që i përket në gjirin e Shteteve të Lirë të Botës.

NUMURI 4

E BOTON KOMITETI KOMBËTAR "SHQIPERIA E LIRE"

1 NENTOR 1953

ZGJEDHJE DEMOKRATIKE

DY FITORE PER EVROPEN

Gjermanët dhe Norvegjezët u dhane një grusht të fortë Ruseve në Evropë

Zgjedhjet politike gjermane përfundimi i të cilave pritej me kaqë kureshtje nga mbare bota, u bënë në qetësi. Me 6 shtator të këtij viti populli zgjodhi lirisht dhe demokratikisht rrugën që do të ndiqe në kater vjetet e ardhshëm, si në fushën e politikës së brendshme ashtu dhe në atë të jashtme. Përfundimi i zgjedhjeve shënon fitoren e madhe të një populli që dëjti të japë provën e qartë të pjekurisë së tij politike të fituar në këte pasluftë. Është një fitore e shkëlqyer e forcave demokratike të Partisë Demokratikë të Kryeministrit Adenauer dhe të partive të tjera të koalicionit qeveritar.

Zgjedhjet dhane këte përfundim: Demokracia Kristjane vota 12.440.790; Demokratët Liberalë 2.628.176; Partia e Profugeve 1.613.474; Partia Gjermane 850.952; Partia Social-Demokratë 7.939.774 dhe Partia Komuniste vetëm 613.413 vota.

Zgjedhjet e 6 shtatorit shënuan disfatën e plotë të partise së nazistëve të ri ashtu dhe të partise komuniste.

Në planin nderkombëtar Gjermanët, duke votuar për Adenauerin, u shprehën kundër çdo mendim kompromisi me Bashkimin Sovjetik, në lidhje me çështjen e unifikimit të Vendiit.

Pas këtyre zgjedhjeve sistemi mbrojtës i Paktit të Atlantikut do të realizohet në një mënyrë të afërte. Kjo gjë e ka dëshpëruar pa masë Moskën. Dhe me shumë urrejtje mbasi zgjedhjet gjermane shënuan një humbje të rëndë për politikën sovjetike në Evropë.

Edhe në Norvegji, zgjedhjet politike që u bënë me 12 tetor të këtij viti konfirmuan suksesin e Partisë Laboriste që kryesohet nga Z. Oskar Torpi. Partia Konservatore fitoi mëjft vota ndërsa Partia Komuniste doli shumë e demtuar. Parlamenti i ri norvegjes do të përbëhet nga 75 Laboristë, 26 Konservatorë, 14 Liberalë, 16 Demokratikë, 4 Komunistë dhe 1 Agrar.

Ç'ngjan përtëj gardhit të hekurt

Në krahinë të ndryshme të Rusisë shpërndahen trakte kundër komunizmit - Në Polloni vazhdojnë ndjekjet kundër Klerit katolik - Prelimet e bërë bujqevet në Hungari nuk u mbajten nga Qeverrija bolshevike.

Jo vetëm në Shqipëri, Bullgari, Rumani dhe në shtetet balltike të roberuara nga Kremli, por edhe mbrenda në Rusi po shpërndahen me tonelate trakte antikomuniste.

Axhentët e policisë ruse nuk dine si t'i bëjnë ball kësave propagandë kundër regjimit. Populli rus ka filluar të kuptojë se maqina shtypese e policisë nuk është aq e fuqishme sa kujtohej. Fryma revolucionare ka marrë hov kudo, dhe në të kater anet e Rusisë po ngjallen shpresat për të përmbytur regjimin tiranik të bolshevizmit.

Në Polloni tashti është burgosur edhe Imzot Lucjan Bernacki, bashkëpunor i ngusht i Kardinalit Wyszinski, internuar disa kohe më parë nga policia e Warshovisë.

Me bu gimin e Imzot Bernackit, numri i krerevet të Klerit katolik, burgosur tashti se fundi në Polloni mberrine në nendë.

Disa kohe më parë, Qeverrija e kuqe e Budapestit dekretoi faljen e detyrimevet të prapambetura bujqevet të Hungarisë.

Gazeta e Budapestit «Nepszawa» shkruan se Partia ka shpërndarë me mijra aktiviste neper krahinat bujqesore për t'u mbushur mendjen katundarëvet të mos largohen nga qendrat bujqesore të kolektivizuara.

Gazeta në fjale, pranon se shumë bujqë janë tërhequr nga propaganda e armiqvet të regjimit.

Populli Shqiptar e ka pruar vet se premtimet qeshake të Qeverrisë komuniste nuk kanë qenë tjetër veç se hi syvet. Bujqet vazhdojnë të punojnë badihava për llogari të Shtetit, të gjithë janë borxhli kundrejt Shtetit, të gjithë janë të dëshpëruar dhe nuk kanë as dëshirë as vullnet për punë.



- Ç'ke aty në koshe, o shoku Malenkov?
- Pleh për komunizmin. Nuk e ka ndëguar se në tjalimin t'im un thash se në Rusi nuk kemi mëjft pleh?

LAJMET E FUNDIT

ËSHTË KRIJUAR NËJE USHTERË I MADHË POLICORE SPECJALE, NË PJESËN E GJERMANISË LINDORE, PËR TË ESPJONUAR PUNËTORET E PAKËNAQUR, SI PËRFUNDIM I TURBULLIMEVET TË FUNDIT. ME GJITH KONTROLLIN E VAZHDUARSHËM TË POLICISË, 18.000 PUNËTORE TË MINAVET TË BAKRIT TË MANSFELD-IT NË GJERMANINË LINDORE KANË PUSHUAR SE PUNUARI NË MUAJIN E TËTOTRIT NË SHENJË PROTESTË KUNDREJT NËJE RREGULLOREJE NË MBËSHËTËTJËN E SE CILËS PUNËTORET DUHET TË PUNOJNË NË SHTATË TË DJELA GJASHTË.

KOMISJONI I REFUGJATEVET TË KOMBËVET TË BASHKUARA KA NJOFËTUAR SE 700 REFUGJATË TË SHTËTËVET KOMUNISTË DO TË SISTEMOHËN NË DËR DOMINIONET E BRËTANJËS SË MADHË.

NË KINË 15 FËTARE JANË LIDHUR ME NJËRA TJËTREN DHE JANË VRARË DYKË U HEDHUR NË DET, SËSA T'U NËNËSHTRËHËSHIN NËJE DEKRETI QË I DËTYRONTË TË MARTOHËSHIN ME NËJE CËRËMONI KOLEKTIVE TË MARTËSES.

THUHËT SE 11 PILOTË TË AVJACJONIT ME REAKSJON JANË ARESTUAR PËRË AGJËNTEVET SOVJETIK TË SIGURIMIT NË GJERMANINË LINDORE. SIG DUKËT PILOTËT KANË DASHUR TË KALOJNË NGA PËRËNDIMI I LIRË. NËJE RAPORT NGA VJËNA FLET SE DY OFICËRË TË USHTËRISË JANË SHDURUR NGA VENDET E TYRË NË ZONËN SOVJETIKE TË AUSTRIËS, DHE PANDEHËT SE U STREHUAN NË ZONËN JO KOMUNISTË TË GJERMANISË PËRËNDIMORE. NUMURI I PERSONELIT TË USHTËRISË RUSE QË KA DËZERTUAR NGA PËRËNDIMI I LIRË ËSHTË DYKË U SHTUAR ME SHPEJTI TË MADHË.

JAN HAJDUKIEWIC, NËJE POLONEZ ANËTAR I NËJE SKUADRE TË INSPEKTIMIT NË KORE, I CILI TANI SHPEJËT KA KALUAR NGA PËRËNDIMI I LIRË DHE MORI STRËHIMIN NË SH.B.A., KA DEKLARUAR SE POLONJA ËSHTË "99% ANTI-KOMUNISTË".

NDEGJONI RADION "ZERI I SHQIPËRISË SË LIRË."

Ora	Metra
06,30	47 dhe 46
13,30	47 dhe 46
18,30	47 dhe 43
21,30	47 dhe 43


DITELINDJA E SKLLAVERONJESIT TE POPULLIT

Tirana njofton se me 16 Tetor eshte kujtuar ditelindja e «shokut» Enver. Te gjitha gazetate e regjimit te kuq thuren elozhe per «udheheqesin e partise e te popullit» dhe harrojne se pikerisht ajo figure meskine eshte shkaku kryesor i te gjitha vuajtjeve e fatkeqesive te nje populli te tere; eshte tmerr per kedo dhe nuk i kujton tjetër gje popullit veçse uri, skllaverim e terror. Do te ishte me mire edhe per vete partine e gjakut qe nje date si kjo t'a linte te kalonte pa e kujtuar, se kujtimi nuk eshte gje tjetër veçse cajtje ne plagen e shpirtit te popullit ne lengim, veçse dhunim i tmershem i sedres kombetare, i vetmohimit te heronjvet, i gjakut te deshmorevet te fisit Arberor. Dhunim e perbufje e therorise se hoveshme te djalerise Shqiptare, qe leftoi e derdhi gjak per t'a pare popullin te lumtur e jo te skllaveruar.

Asnje elozh; asnje propagande e asnje shtyp nuk mund t'a mbuloje e t'a paraqitij me tjetër fytyre vepren tradhetare te Enver Hoxhes. Veprat i tregojne punet dhe punet tregojne se sot Populli Shqiptar vuan si s'ka vuajtur kurre.

S'ka perbufje as poshtersi me te madhe se te kerkosh hare e kenge nga buzeplasuri, nga ay qe i ka syte me lot e zemren te pikelluar, nga ay qe e sheh se femija ka uri e s'ka ç'ti jape. Por s'ka fund poshtersija komuniste!

Prandaj ndersa meskinet qe e rrethojne i kendojne lavd Enverit, Populli Shqiptar, i tere populli betohet mbi Flamurin me Zhgaben dykrenore, qe perfaqeson trimerine, therorite e brezpasbrezeshme te fisit Arberor, betohet, si di te betohet Shqiptari; t'a rrezoje tradhetarin e te fitoje lirine e te rroje me nder e kryelarte ne trojet e te Parevet te tij.



Puntoret gjermane kunder roberise ruse

BURE AMERIKANE KUNDER URISE RUSE

Me 10 tetor te k.v. mori fund shperndamja e pare e gjanavet ushqimore qe Presidenti Eisenhower u dhuroi banorvet te Gjermanise Lindore. Gjat 11 javeve u shperndane ne Berlin 5.500.000 racjone. Megjithë ndalimet e autoritetevet komuniste Gjermanet e Zones Lindore moren gjithsej 55.000tonelate miell, 5.000 tonelate dhjame de 20.000.000 kutia qumesht. Sipas lajmevet te fundit gati 80% e banorvet te Berlinit Lindor kane marre nga 2 racjone me ushqime.

Mbas pak javesh do te filloje nje shperndamje e re ne gjana ushqimore e veshmbathje.

Ruset perbufzin ne Vjene "Shoket Shqiptare,"

Fletorja «New York Post» e dates 18 Gusht 1953 shkruan:

«...tani vone disa te ashtuqajtur delegate sindakatah Shqiptare arriten ne Vjene. Keta vine me rrall se perfaqesuesit e vendeve te tjere te udhehequr prej Bashkimit Sovjetik. Jane Shqiptare, prej me t'egrit vend policor qe administrojne Ruset. Kujtuam se delegatet ne fjale do te kishin informata te

sakta mbi gjendjen e brendeshme te Shqiperise. Shkuam ne Ambasaden Sovjetike dhe Ruset na thane me indifference, se nuk tregonin interesim te veçante per turistet Shqiptare. Rastesisht zbuluam se ku shkonin delegatet Shqiptare per te pire kafene. U ulem me nje tryeze prane tyre. Delegatet ishin te rinj nga mosha dhe te veshur keq, por kraharorin e

THIRRJA QE BANI KOMITETI

Komiteti Kombetar «Shqiperija e Lire» asht i informuem se ne sferat e larta te Partise se Punes ka deshperime te thella dhe reaksione te fshehta. Komiteti qe ndjek me kujdes pendimet e atyne qi u gjenyen nga fjalet e mira te Bolshevizmit robnuet e gjakatar, mendoi t'u hapi udhen e kthimit ne perpjekjen kombetare, gjith atyne komunisteve qe nuk i kane duert te lyame me gjak, gjith atynove qi burren nishit pranojne se gabimet e kalueme lahën me perpjekje te perbashketa per çlirimimin e popullit te robnuem.

Prandaj u bani dhe po u ban thirrje te vazhdeshme zyrtavet te natte te Komunitetit te falimentuem dhe

te denuem nga populli Shqiptar qe te gjejne rrugen e nderit dhe te Shqiptarizmit para se te jete teper vone.

Çdo guxim i treguara per te ndihmuar popullin e shtypun, per te perkrahe forcat e lirise per t'u bashkuar me Komitetin Kombetar «Shqiperia e Lire» do te çmohet dhe do te ndihmohet pa kursim.

Nuk asht kurr vone me ndrrue rrugen e gabueme dhe me u hjedh nga ana e Atdhetarvet e demokratvet qi po perpiqen, te perkrahuin nga bota e lire, per çlirimimin e Atdheut te robnuem.

Mos pritni ditën e fundit, pse fundi i agjentevet te Moskes ne Shqipni mund te vije ma shpejt se ç'mendohet.

kishin plot me nishane. Me ta ishin edhe kater udheheqes. Dy prej delegatvet Shqiptare flisnin nje gjermanishte te mire.

Deshem te mesonim ndo nje gje prej tyre per gjendjen e brendeshme te Shqiperise dyke qene te bindur se do te na pergjigjeshin, mbasi disa dite me pare — nga sa shkruante gazeta Pravda — Moska ishte e mendimit se sistemi sovjetik dhe kapitalizmi mund te bashkejetonin. I pyetem: «A mendoni se Mehmet Shehu eshte ne gjendje sa te rrezoje Enver Hoxhen?» Delegatet pine me te shpejte kafete, na veshtruan me verretje dhe iken me njehere, pa na u pergjegjur, bile as bakhshin nuk i lane çunit qe sherbente.

Per te qare e per te qeshur

Kur Enver Hoxha mbushi 3 vjet, Mullah Halili, i ati, e futi ne nje dhome dhe i vuri perpara Kurandin, nje molle dhe nje napolon Pastaj doli, mbylli deren dhe e la vetem:

Mullah Halili mejtonte:

«Ne qofte se Enveri merr Kurandin, do t'a dergoj ne medrese te behet hoxhe; po qe se ha mollen atehere do t'a dergoj ne shkollen e bujqesise dhe ne qofte se merr napolonin, atehere do t'a bej tregetar ose bankjer».

Kur Mullah Halili, mbas 10 minuta u kthye dhe hapi deren Enveri ishte ulur mbi Kurandin dyke mbaruar se ngreni mollen, dhe napolonin e kishte futur ne xhep.

Dihet se ne Tirane problema e mungeses se banesavet esht e pa zgjidheshme. Esht mbase kriza me e madhe e qeverise se Shqiperise.

Mejto sot, mejto neser, me se fundi Sheraf Mendja e gjeti nje nate se si duhesh bere, dhe qe me mengies kerkon udhçnce te Enver Hoxha.

— Shoku kryeminister, i tha sa po hyri, une kam gjetur nje menyre te thjeshte se si te zgjidhet problema e shtepivet qe mungojne.

Enver Hoxhes i ndriti fytyra nga gezimi dhe u-çua pernjeheresh ne kembe.

— He..., i tha

— Le t'i jepet çdo Shqiptari nje pasaporte dhe le te lihet i lire te shkoje ku te doje jash-ta shtetit. Mbrenda javes problema e mungeses se banesavet eshte e zgjidhur.

SHQIPERIA

SHKURTIM LAJMESH

SHQIPERIA është organi zyrtar i Komitetit Kombëtar «SHQIPERIA E LIRE»; një organizatë e përbërë nga përfaqësuesit e Shqiptarvet të çdo shtrëse shoqërore dhe levizje politike, të cilët marrin pjesë në kryqëzaten bolerore kundër tiranisë komuniste për çlirimin e Atdheut.



Komiteti Kombëtar «SHQIPERIA E LIRE», u është kushtuar këlyre puneve: 1) Të mbrojtë të drejtën e Shqiptarvet që të zgjedhin lirishit regjimin që u pelqen; 2) Të zhvillojë marrëdhënie të mira me Shtetet (qinje); 3) Të sigurojë njohjen e kufiut tokësor të Shqiperisë; dhe 4) Të japë Shqiperisë vendin që i përket në gjirin e Shteteve të lira të botes.

NUMURI 6

E BOTON KOMITETI KOMBËTAR "SHQIPERIA E LIRE"

15 DHJETOR 1953

FLAMURI I GRISUN

Jane mbushum 10 vjete nga dita tragjike e luftes civile ne Shqipni.

Rezistenca shqiptare e përbërë nga çeta të panumërta, pregratitë nder malet e lira të marshohe mbi qytetet e robnueme. Priteshin luftetaret, priste populli.

Krisi pushka vllavrasese!... Me urdhen te huej. Per qellime te hueja.

Partija Komuniste e dejun me parimet e Stalinit hapi zjari mbi nacionalizmin shqiptar. Shau e shpifi e vrau me ate shpejti te rrefeshme, qi cilson agjentat e diktaturavet t'importueme. Filloi te ngrihej ylli i diktatures komuniste.

U habit bota, u trubullue mendja e Shqiptarvet!...

Kush vriste padiste te vramit si shkaktare te ksaj lufte t'eger! Kush trathlonte n'emen te Rusise padiste per trathtare ata qi bijshin n'emen te Shqipnise! Keshtu nga Jugu, neper Shqipni te mesme e deri ne Veri kaluen me nji flamur te huej, milicet e Stalinit tue gnyje, tue tmerue, tue i qile vorrin Kombit!

U hap nji lajm: Atje ne Skrapar, Mehmet Shehu me nji ceremoni t'eger zbriti nga shtiza Flamurin e Atdheut me te cilin kishte gnyje Shqiptaret, e grisi, e beshtyni, e hodhi ne pluhun dhe ngriti tue e puthe me nderim flamurin me drapen e çekan!...

Nji pjese.e botes se gnyjeme nuk desh te besoje. Nuk diji te dalloje ç'do te thonte ay flamur i grisun ke kambet e Mehmet Shehut! Dhe nuk u kujtue n'ate shpejti hakmarrjesh e ndeshjesh te çmenduna se ate dite bashke me Flamur, po binte lirija e Shqipnise, lirija e Shqiptarvet!...

Krahnoret e qendisun me plumba iu bane mburoje ktij Flamuri te grisun. «Te vdesim ne, por te rroje Shqipnija» bertiten luftetaret qe renden ne kushtrimin e Flamurit te permbysun. Mijat e deshmorvet qi rane rreth Shkabes shekullore u perjetsuen si shembuj te pakuptuem mire nder faqet e historise kombetare!

U afrue Nandori i vjetit tragjik 1944. Triunfoi trathitja e Enverit, e Mehmetit. Kohet e Haxhi Qamilut u persriten me nji vrull e fuqi tmeronjese.

(vijon ne faqe 2)

C'ngjan pertej gardhit te hekurt

Roja e vjeter kritikoket ne Hungarine Komuniste. Me vendimin zyrtar she-nohet akuza per sabotim te politikës per nje jete ma te mire te popullit. Ne Rumania jane denue 12 vete me vdekje. Pese Çekosllovakë tentojne t'aratisen Police te Republikës Sovjetike Gjermane aratisen ne Perendim

Partija Komuniste Hungareze është ankuar se Komunistat e Rojes se vjeter kane vazhduar te sabotojne politiken e te ekonomike Hungareze per te shtuar ushqimet dhe artikujt e tjere.

Nje vendim i marrun me 31 Tetor prej Partis Komuniste Hungareze ne lidhje me kete u botua me 6 Nentor ne Organin Komunist te Budapestit, Szabad

Nep. Komunikata thot se vendimi i marre ne Korrikun e shkuar, per te pakesuar prodhimin e industrise se rende ne favor te prodhimit te ushqimevet dhe te artikujve te tjere te nevojshem per masat kje i drejt. Por ky vendim nuk u zbatua, dhe bile, shton fletorja, «hasi ne rezistence te hapet ne qarke te partise».


Nga kjo deduktohet se mund te behen akuza kundra dhe ndrshime ne radhet udheheqese te partise dhe se parulla e re «me pak topa e me shum gjalp» ka fituar pelqimin edhe te vet Moskes.

Mbi kete politike M. Nagy gjet kundershtrim nga M. Rakosi. Kremlini i dha te drejt Nagyt. Vendimi i botuar thot edhe: «Programi yne është mbaitja e standardit te tashen te industrise dhe permiresimit te bujqesise, Me ndihmen e industrise s'one shum te zhvilluar ne do te mundim t'a permiresojme edhe me teper bujqesine. Ky ka per te qene plani yne per dy-tre vjetet e ardheshem».

Lajmet qe vijne nga Rumanija vertetojne se ndjekjet dhe terrori vazhdojne pa pre.

Ne kohet e fundit jane denue

(vijon ne faqe 2)



Ky është i përi top atomik qe është prurë ne Evropë nga ushtria e Shteteve të Bashkuara. Ky top, qe ka një kand naltësimi prej 0° gjër 55 grada, i është treguar publikut ne qytetin Mainz te Gjermanise.

LAJMET E FUNDIT

15.000.000 DOLLARË (750.000.000 LEK) JANE DHENE NGA SHTE-TET E BASHKUARA TE AMERIKES PER TE NDIHMUAR GJERMANINE PEREN-DIMORE NE NDERTIMIN E SHTEPIVE PER REFUGJATET NGA SHTETET KO-MUNISTE.

ESHTE DEKRETUAR NJE LIGJ NE KUBA NE MUAJIN E NENTORIT DYKE VENE JASHTE LIGJIT PARTINE KOMUNISTE, DHE JO ME PAK SE 50 UDHE-HEQSA TE PARTISE JANE ARSTUAR PER VEPERIMET SUBVERSIVE KUN-DER QEVERISE.

NE TETOR POPULLI AMERIKAN KA DHENE 500.000 KG GJALPE GJER-MANEVE TE LINDJES QE JANE TE URTUAR "HE QE KETA KANE MUNDUR TE RESHQASIN NE BERLININ PERRNDIMOR, PER TE MARE DHURATAT.

NDEGJONI RADION "ZERI I SHQIPERISE SE LIRE,,

Ora	Metra
06,30	47 dhe 46
13,30	47 dhe 46
18,30	47 dhe 43
21,30	47 dhe 43

FLAMURI I GRISUN

(vijon nga faqe 1)


Aj: «duem baben», kta: «duem xha Stalinin!» Dhe u dejen me gjakun e vllazenvet te pafaj.

Ne qi tepruem nga kjo shtergate gjaku muerrem udhet e mergimit. Me vehte muerrem flamurin e grisun, kujtojme sod 9 vjet e robnise se popullit t'one.

Sod ma nuk kemi nevoje t'i themi popullit si dhjete vjet ma pare: hapni syt, komunizmi asht varri i Shqipnis. Bashkadhetares t'one po jetojne mbrenda atij varri.

Perpjekja e Shqiptarvet te merguem, te mbledhun rreth Komitetit Kombetar «Shqipnija e Lire», bashkohet sod me vuezjet, me rezistencen madheshtore shqiptare qi pohan çdo dite Kombin e Flamurin perballe gjaksorvet te Moskes.

Mbi Flamurin e grisun, mbi Flamurin e arratisun ata kndojne tue i hape gjoksat plumbavet. Ja vdekje ja liri.



Ç'ngjan pertej gardhit te hekurt


(vijon nga faqe 1)

per «sabotazhe» dhe veprime kunder regjimit te kuq 12 njezet te pafajshem.

Pese Çekosllovake tentuen javen e kalueme t'arratisen ne Perendim; prej ketyne dy mbeten te vrave dhe tre te tjeret munden te shpetojne dhe mbritten te gjalle ne sektorin perendimuer te Berlinit.

Gjate muejt Tetuer jane aratis 537 police (te Volks Polizei) te «Mbrojtjes se Popullit» ne Gjermanine Perendimore. Prej ketyne 44 ish-in oficera. Gjithesejt jane aratis gjate 10 muejvet te fundit 3972 police te regjimit te Grotewohl-it dhe Pieck-ut. Keto aratisje te vazhdueshme dhe me shumice, vertetojne se me sa «bindje» dhe me sa «zell» asht e mbrojtun Republika Bolshevike gjermane.

MIZORITE KOMUNISTE NE KORENE E VERIUT



Keta jane 300 veta te cilet, ne Koré te Veriut, vdiqen per mungese ajri, kur komunistet mbyllen te hyrat e shpellave ku keta te gjore kishin kerkuar shpelim nga ndjekjet e te kuqvet.

Koreanet e Veriut kishin dashur te torturonin Xheneralin Dean

Xhenerali amerikan Dean, qe kish rene rob neditet e para te luftes ne Kore, deklaroi se, ne Shjator 1950, kish dashur te vriste vehten per te mos treguar, po t'a torturonin, disa te fshehta ushtarake.

Rojtaret e burgut i kishin thene se do t'i futnin cita ne ne thonjt e pastaj do t'u jepnin zjarr, qe t'a shtrengonin te fliste. Veçanerisht donin hollësira mbi planet e mbrojtjes se Japonise.

Nje dite kur rojtari i burgut po dremiste, xhenerali Dean i u versul dhe i rrembeu mitrolozin. Kish vendosur te vriste oficerin qe i kish thene se do t'a torturonte dhe pastaj t'ja hiqte edhe vehtes. Por punet nuk shkuan si i kish parashikuar. Dyke hyre ne dhome gje ti pa pritur nje oficer komunist. Xhenerali Dean desh te shtinte mbi te, por arma ngeci. Me nje here i u versulen kater a pese veta dhe e çarmatosen.

NJE THIRRJE E KOMITETIT KOMBETAR "SHOIPERIA E LIRE,"

Komiteti Kombetar «Shqipëria e Lire» eshte i bindur se brenda ne Partine e Punes njerës me pozita te larta e kane kupetuar se planet komuniste kane deshtuar ne te gjithë anet. Komiteti Kombetar «Shqipëria e Lire» e quan te nevojshme qe keta njerës te penduar, ne qofte se nuk i kane lyer duart me gjak te popullit, te kthehen ne rrugen e drejte dhe te bashkepunojne per çlirimin e Kombit me te gjithë atdhetaret. Kjo thirrje eshte bere edhe te tjera here; po e perserisim edhe nje here per hir te interesit te larte te

Atdheut, qe te gjithë ata qe jane penduar te mos humbasin kohe, te mos presin oren e fundit, por te radhiten me njehere prane forcave te luftojne tiranine me gjakatare qe ka njohur historija e vendit t'one.

Per patriote te ndershem dhe ne mirebesim nuk eshte kurre von te perkrahin dhe te bashkepunojne per shpëtimin e Shqipërisë. Kete te vertete fort te nevojshme per keto çaste kritike me shume se kushdo tjetër e çmon Komiteti Kombetar «Shqipëria e Lire».

Der te qare e per te qeshur

LOPET SOVJETIKE

Fletoria komuniste «Der Spiegel» qe botohet ne Gjermanine Lindore, na ben te ditur se lopa «Walze» ka dhene 10.661 litro qumesht ne nje mot-mot, qe kurse teknika e ushqimit dhe e mjeljes se lopevet u zbatua edhe ne Gjermani.

Te turperuara nga kjo lope, ne Hungari lopet kane filluar nje kundrasulni dhe kane shpallur nje gare me shoqet gjermane. Keshtu qe tani marrim vesh nga shoku Andras Zsibrita, presidenti i komisjonit te fambrikes se ne nje ndermarrje shteterore ne qytetin Mozohegyes, se 200 lopet qe ay administron kane shtuar nga 15 deri 30 mije litro qumesht ne nje muaj vetem. Pese nga ato 200 lope jane lope stakanoviste.

Nuk dime se ç'behen lopet ne Shqiperi dhe ne vendet e tjera.



Mesuesi: - Ruset grurin e korrin shlate here ne vjet: nje here ne Rusi dhe kusurin ne gjashte Republika Popullore Progresiste.

te Republikave Popullore Progresiste.

Per sa i perket Rusise vete, Radio Moska ka lajmeruar se mekaniku sovjetik Pavel Bikov ka mbaruar normen e punes se tij deri ne vitin 1963. Pavel Bikov eshte superstakanovist.

MOS FOLNI POLITIKE

N'oborrin e fabrikes se tekstilevet prej leshi dhe prej pam-buku, ne Tirane, kater puntore me duar ne xhep, po rrine ne kembe dhe nuk fjalosen.

Njeri desheron te thote ndo-nje fiale, por hesht. Av hap krahet dhe veshturon perpjete si nje njeri i deshpëruar qe s'ka ce ç'shpreson. I dyti puntor, edhe ay ka arsye qe te thote diçka, por pa fjale shtrengon grushtet dhe i ve ne goje dhe i kafshon me inat. I treti nuk i nxjerr duart nga xhepi, por peshdyn perdhe me urrejtje. Tani shoku i katert, i shikon te tre dhe i qorton: — Filluat pra! te llafoseni per politike?